POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 I dashuri e çon në Romë për t'i propozuar martesë, vajza i thotë 'JO'! VIDEO bën xhiron e rrjetit
2 I maskuar si kameraman, Kylian Mbappe zbukuron ditën e dy fëmijëve te PSG-ja (VIDEO)
3 E rëndë në Greqi, 2 shqiptarë hyjnë t'i grabisin banesën, njëri godet 10 herë me thikë të moshuarin
4 Efektivi plagosi 26 vjeçarin në Fier, policia: I riu tentoi të hynte me makinë aty ku zhvillohej koncert! Doli nga makina dhe goditi me grushte inspektorin
5 Ligji i ri / Prej vitit 2024 ndryshon tatimi i pronës e truallit, 15% tatim për pasuritë e dhuruara ose trashëguara

Kronikë

Fier/ S'u la të futet me makinë në qendër ku ishte koncerti, autori i përleshjes me armë në spital në 2019 rreh policin, neutralizohet me plumb në këmbë (Video-Emrat)

26 vjeçari Daniel Braçi me precedent penal, u konfliktua këtë mbrëmje me patrullën që nuk e lejoi të hynte me makinë në perimetrin e sigurisë së një koncerti në qendër të Fierit. I riu filloi të godiste policin me grushte por u qëllua me plumb në këmbë nga efektivi Shkëlqim Jahelezi për tu neutralizuar

- 26 vjeçari me precedent kriminal! Përleshja në spital në 2019: I rrëmbeu armën një polici dhe kreu plagosje
- Del emri i efektivit dhe 26 vjeçarit që u përleshën në qendër të qytetit
- Policia reagim zyrtar: Efektivi e plagosi për t'u vetëmbrojtur, pas spitalit është shoqëruar në komisariat

Redaksia
28 Dhjetor, 19:42 | **Përditesimi: 28 Dhjetor, 23:00**

Share

Ndalimi për të hyrë në qendër të Fierit për shkak se aty po organizohet një koncert ka qenë shkak për të riun Daniel Braçi i mjohur për drejtësinë, që të përleshet me policin Shkëlqim Jahelez i cili me pas e ka plagosur me armën e shërbimit për ta neutralizuar.

Siç njofton policia, 26 vjeçari Braçi duke drejtuar një automjet tip "Volksëagen" është afruar te punonjësit e Policisë dhe ka tentuar të futet në rrugën e bllokuar për zhvillimin e një koncerti.

Punonjësit e Policisë nuk e kanë lejuar të futet brenda perimetrit të sigurisë dhe në atë momentet i riu ka dalë nga automjeti dhe ka qëlluar me grushte në fytyrë njërin prej tyre duke i shkaktuar dëmtime në fytyrë dhe në gojë.

LEXO EDHE:
AKU kontrolle në Durrës, Korçë e Fier, 300 mijë lekë gjobë për 3 biznese

Në atë moment inspektori e ka qëlluar me armën e shërbimit duke e plagosur në këmbë. Të dy janë dërguar në spital dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Më pas polici është shoqëruar në Komisariatin e Policisë për veprime të mëtejshme.

26 vjeçari Daniel Braçi në 2019 ***është përfshirë në sherrin me thika dhe armë zjarri*** në Levan dhe në Urgjencën e Spitalit të Fierit. Ai i mori armën nga brezi një oficeri të patrullës së policisë dhe plagosi me të Aleksandër Zhapaj gjatë kohës që të dy po shoqëronin në spital të afërm të lënduar ***gjatë një sherri në një lokal*** në Levan të Fierit. Vëllai i Daniel Braçit. Për këtë ngjarje ndaj tij Gjykata e Rrethit Fier caktoi masën e sigurie "Arrest me burg" për "Vrasje me dashje mbetur në tentativë", "Goditje për shkak detyrës të punonjësit të rendit publik".

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:27

Rrahu efektivin, 26 vjeçari i plagosur me precedent kriminal! Sherri mes dy familjeve dhe përleshja në spitalin e Fierit: Plagosi një person me armën e policit

HOROSKOPI
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Daniel Braçi, 26-vjeçari që tentoi të çante bllokimin e policisë në Fier dhe u përlesh me një polic rezulton me precedent të mëparshëm penal. Ai njihet si person problematik ne fushën e konflikteve. Më 31 gusht 2019, i riu, ***pas një konflikti mes dy familjeve*** Zhapaj e Braçi, nga e cila mbeten të dëmtuar me sende të forta dhe thika katër persona, ka marrë armën e shërbimit një prej punonjësve të Policisë që po ndihmonte të plagosurit të futeshin në urgjencë, dhe ka plagosur me këtë armë një prej familjarëve të palës tjetër. Përplasja aso kohe ka ndodhur brenda spitalit të Fierit.

Konflikti mes dy palëve kishte nisur në pasditen e 31 gushtit në një lokal në Levan të Fierit. Nga konflikti mbeten 5 të plagosur nga të dyja palët. Sherri i nisur në lokal me sende të forta dhe thika, përfundoi në një skenë edhe më të përgjakshme në Urgjencën e Spitalit të Fierit, ku u transportuan të plagosurit me sende të forta nga sherri në lokal.

Policia bëri me dije se Daniel Braçi atëherë 21 vjeç, që po shoqëronte në spital dy prej të afërmve të tij të dëmtuar, (Erlind Muçaj dhe Klajdi Lamaj), i mori armën nga brezi një punonjësi të policisë, dhe qëlloi ndaj një prej familjarëve të palës tjetër, Aleksandër Zhapës, duke e lënë të plagosur. Zhapa nga ana e tij ndodhej në spital për të shoqëruar dy djemtë e tij, Gentian dhe Aldi Zhapa të cilët kishin mbetur të plagosur me sende të forta në lokal në Levan.

Nga konflikti me mjete te forta dhe thika mbetën të plagosur Gentjan Zhapa, Aldi Zhapa, Erlind Muçaj dhe Klajdi Lamaj. Policia arrestoi për ngjarjen në Fier dy vëllezërit Daniel dhe Gazment Braçi ndërsa nga pala tjetër u arrestuan Emiglent Kararaj, Aldo Zhapaj dhe Aleksandër Zhapaj të përfshirë në konfliktin në Levan.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 21:21

Plagosja në Fier, del emri i efektivit dhe 26 vjeçarit që u përleshën në qendër të qytetit



Daniel Braçi, është 26-vjeçari që u përlesh me efektibin e policisë këtë mbrëmje në qendër të Fier për shkak se nuk e la që të futej në rrugën që ishte bllokuar për t'u zhvilluar një koncert. Efektivi i policisë që e plagosi është Shkëlqim Jahelezi.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 20:13

Efektivi plagosi 26 vjeçarin në Fier, policia: I riu tentoi të hynte me makinë aty ku zhvillohej koncert! Doli nga makina dhe goditi me grushte inspektorin

Policia e Fierit ka dalë me një njoftim zyrtar sa i takon plagosjes së të riut 26 vjeçar D.B nga inspektori i policisë Sh.J.

Sipas njoftimit, i riu me një makinë tip “Volsëagen” tentoi të hynte në rrugën e bllokuar ku po zhvillohej një koncert.

Polici nuk e ka lejuar të kalojë perimetrin e sigurisë dhe për pasojë 26 vjeçari ka dalë nga makina dhe e ka qëlluar me grushte në fytyrë duke i shkaktuar dëmtime të rënda në fytyrë dhe gojë.

Në këtë moment inspektori ka reaguar duke nxjerrë armën e shërbimit dhe duke e plagosur në këmbë të riun i cili tashmë po merr trajtim mjekësor në spital dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

> *“Ndërkohë është shoqëruar në spital për ndihmë mjeksore dhe punonjësi i Policisë, shtetasi Sh. J. dhe pas marrjes së ndihmës mjekësore është shoqëruar në Komisariatin e Policisë për veprime të mëtejshme. Të gjitha veprimet po kryhen nga Agjensia e Mbikëqyrjes Policore në drejtimin e Prokurorisë për shmangur konfliktin e interesit”- thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.*

B.V/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:51

Detaje nga plagosja e të riut në Fier, polici nxorri armën e shërbimit dhe e qëlloi në këmbë! U konfliktuan në qendër të qytetit

Report Tv ka mësuar detaje të reja rreth ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e sotme në qendër të qytetit të Fierit, ku një efektiv policie ka plagosur me armën e shërbimit një person.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 19:30, kur polici është konfliktuar me një të ri, i cili dyshohet se kishte shkaktuar probleme gjatë një aktiviteti në qendër të sheshit të qytetit.

Gjatë konfliktit, polici, i panikosur në atë moment ka nxjerrë armën dhe e ka plagosur të riun në këmbë. Ky i fundit është dërguar në spital, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

B.V/Shqiptarja.com

Share

B.K/Shqiptarja.com

TAG: te shtena me arme | Fier | shkelqim jahelezi | daniel braci

Komento

Komente

Ati: 29/12/2023 07:32

Po ky tipi duhet te ishte brenda per ate vepren qe ka bere ne 2021 si na delka qe qenka verdalle?? Ja nje rast per ILD qe re shkarkoj gjith prokurore dhe gjyqtare qe e kane lene jasht kete te prapambetur

Përgjigju

ylli: 29/12/2023 05:25

plumbin ballit ti kishe futur o polic...ku lejohet te vihet dore mbi policin...

Përgjigju

Tiku: 29/12/2023 04:43

Ky eshte kulishi i kulishit te Gramoz Rucit,atehere i mori armen policit dhe beri plagosje brenda ne spital te Fierit sot qelloi policin ne qender te Fierit.Kush do e ndalonte Arjan Hasani i policis Fier kulishi tjeter i Gramoz Rucit apo ata kulishat tepelens te Prokuroris Fierit

Përgjigju

Jim: 29/12/2023 03:17

Po te kishte qene ne nje vend tjeter SHBA ose ne Gjermani a diku tjeter plumbin do ta kishte marre ne koke sic e kerkonte! Shpresoj qe atij policit mos i japin ndonje mase ndeshkimore Por Falenderim per punen e mire ndryshe do te ulni reputacionin e shtetit !

Përgjigju

Iris: 29/12/2023 01:53

Tek ne,kur behen festivale ose parada,njoftohet qe me perpara qe ka kufizime,apo ndalime dhe jepen rruget alternative qe mund te perdoresh.Nuk eshte e qarte nese ky donte te hynte ne sheshin ku po zhvillohej festivali me makine,apo kishte shtepine aty,s.d.q.kesaj rradhe provoi mbi vete pak nga metodat qe kishte ushtruar me pare ndaj te tjereve.Lesson learned!!

Përgjigju

Turi: 28/12/2023 22:37

Shteti nese nuk denon ashper ata qe jane te dhunshem atehere ka mare fund dhe aq me keq kur sulmohen forcat e rendit , me sa duket ky garipi e ka ber rruge sepse nuk i kane futur sallatorin si dubet heren e pare

Përgjigju

Spendi: 28/12/2023 22:26

Bravo policia po heres tjeter ne balle se kta mostra me brire e meritojne. Ai polic duhet graduar jo si ata tipat qe ulin koken para ktyre llumrave te krimit.

Përgjigju

Populli: 28/12/2023 22:12

Policit ti jepet shpërblim dhe ngritje ne grade. Respekte për policin. Plehra meritonte plumbin kokes dhe jo ne këmbë.

Përgjigju

Gripi: 28/12/2023 21:56

Dihet kujt bande nga levani i perket, dihet kush i mbeshtet fort edhe perse gjoja i terhequr nga politika nen presionin se ndryshe do shpallej non grata. Policia dhe Prokuroria e Fierit nuk ka kellqe ti tregoje vendin kesaj bande. Dergoni operacionalen nga Tirana ti marrin zvarre dhe ti cojne ne Spak sepse as prokuroria e tiranea me 4 Felaj brenda nuk i jep drejtim. Guximi i ketij horri vjen nga suporti politik. Uroj qe te perplasen me ata qe ju tregojnw vendin, se fieri ka plot dhe nuk ja lene mangut. Keqardhje per policin sepse eshte dhe do mbetet i vetem ne kete situate.

Përgjigju

Per kinostudion: 28/12/2023 21:14

Mire ja ka ba ku.es Si qellohet polici ne sherbim o jari

Përgjigju

Andi: 28/12/2023 20:31

Si thotë amerikani? F*ck around and find out. Kokebosha

Përgjigju

haha: 28/12/2023 22:42

ne amerike ta futin plumbun ne koke, nderkohe qe te jane ulur mbi zverk.

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Si e parashikoni ekonominë tuaj familjare për vitin 2024?

Më mirë | Më keq | Pa ndryshime

Lajme të tjera



Shiste fishekzjarrë dhe kapsolla kontrabandë, vihet nën hetim pronari i një dyqani në Roskovec

28 Dhjetor, 10:10

Lushnje/ Zjarri tek qendra tregtare, Prokuroria hap procedim penal, merren në pyetje pronarët dhe 30 dëshmitarë! Dyshimet e para

27 Dhjetor, 14:54

Fier/ 'Benzi' përplaset me zetorin në aksin Levan-Tepelenë, plagoset shoferi i mjetit bujqësor

26 Dhjetor, 19:28

Zjarri në qendrën tregtare në Lushnje shkrumboi rreth 300 biznese, nesër ekspertët e Institutit të Ndërtimit vendosin për fatin e godinës

26 Dhjetor, 17:47

Fier/ Tentoi të vriste një 30-vjeçar duke qëlluar me armë drejt berberhanes, arrestohet autori, një ditë më parë u kap bashkëpunëtori (Video)

26 Dhjetor, 15:05

Flakët në qendrën tregtare në Lushnjë, zjarrfikësi: S'kishte mjete e as rrugë për të kaluar! Inxhinieri i ndërtimit: S'ka funksionuar sistemi kundër zjarrit

26 Dhjetor, 12:45

Ekskluzive/ Pamje nga brenda qendrës 'Metropol' në Lushnje, momenti kur zjarrfikësit luftojnë me flakët, gjithçka e shkrumbuar

26 Dhjetor, 12:04

Zjarri në qendrën tregtare në Lushnjë, kryebashkiakia për Report Tv: Kemi vetëm 2 zjarrfikëse pa autoshkallë, pritëm që të vinte nga Fieri

26 Dhjetor, 10:48

AKU kontrolle në Fier, marketi me ushqime të skaduara! Shkelje edhe një subjekt në Korçë

26 Dhjetor, 10:10

Zjarri në qendrën tregtare në Lushnjë, pronarët e dyqaneve me lot në sy: Katastrofë, 500 familje ushqeheshin këtu! Humbëm miliona lek mall

26 Dhjetor, 09:46

Lushnjë/ Zjarri në qendrën tregtare 'Metropol', dyshohet se nisi nga një dyqan këpucësh! Nisin hetimet! Zjarrfikësit pa autoshkallë

Yrjet Saliasi

26 Dhjetor, 08:47

Zjarri në qendrën tregtare të Lushnjës, Goxhaj apel banorëve të bllokuar: Mos hapni dyert, prisni t'ju evakuojnë ose dilni në tarracën e pallatit

25 Dhjetor, 17:32

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje